

NJOFTIM
Nr. 1690, datë 22.2.2019

SHPALLJE TË 1 VENDI VAKANT
PËR POZICIONIN SPECIALIST PËR ZBARDHJEN DHE REDAKTIMIN E
VENDIMEVE
NË INSTITUCIONIN E KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT

Në zbatim të nenit 20, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit shpall fillimin e procedurave për personat e interesuar, që kërkojnë të aplikojnë për pozicionin “Specialist për zbardhjen dhe redaktimin e vendimeve” në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, kategoria e pagës: IV-a.

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

- a) Të zotërojnë diplomë të arsimit të lartë në degën gjuhë-letërsi.
- b) Të kenë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
- c) Të kenë të paktën tre vjet përvojë pune në profesion.

Kushte të përgjithshme:

- Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret për t’u pajisur me certifikatë sigurie sipas vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 188, datë 4.3.2015.

- Ndaj tyre të mos jetë nisur procedim penal, të mos jenë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi ose kundërvajtjeje penale.

- Ndaj tyre të mos jetë marrë masë disiplinore me largim nga detyra ose ndonjë masë tjetër disiplinore, e cila është ende në fuqi sipas legjislacionit në momentin e aplikimit.

- Kandidatët duhet të kenë aftësi për t’u përshtatur e punuar në grup, nën presion, si dhe në afate kohore të limituara.

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentet e mëposhtme:

1. Kërkesë me shkrim, shprehje interesi.
2. Jetëshkrim profesional, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare.
3. Kopje të dokumenteve (diplomë, letërnjoftim, librezë pune) (originale ose të noterizuar).
4. Dëshmi penaliteti.
5. Vlerësimin e fundit nga eprori direkt.
6. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

Aplikimet duhet të dorëzohen brenda 15 ditëve pas publikimit të njoftimit pranë institucionit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit në adresën: “Rruga e Kavajës”, Ish-Lidhja e Shkrimtarëve, Tiranë, zyra e protokollit, nga e hëna në të premte, ora 8:30-17:00, ose nëpërmjet postës elektronike në adresën: info@kpk.al, i cili konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.